



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VIII

Sesioni vjeshtor

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Mbledhja nr. 56

Prishtinë, më 26.9.2024, në orën 9:30

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

PROCESVERBAL

Morën pjesë: Hydajet Hyseni Kaloshi, zëvendëskryetarë, Bahrim Shabani, Drita Millaku, Arjeta Rexhepi, Valentina Bunjaku Rexhepi, Enis Kervan, Shemsedin Dreshaj, Adem Hoxha, Fridon Lala dhe Bekim Arifi, anëtarë.

Munguan: Elmi Reçica dhe Fadil Gashi.

Të pranishëm të tjerë: Leonora Gashi, asistente e GP AAK; Orgest Topojani, asistent i GP-PDK; Zllka Kllokoqi, përfaqësuese e KDI-së; Lulzim Kelmendi, përfaqësues nga KIE; dhe Celal Iliaz, Drejtorja për media dhe marrëdhënie me publikun.

Stafi mbështetës i Komisionit: Natasa Prica-Tishma dhe Drita Çarkaxhiu.

Mbledhjen e kryesoi: Hydajet Hyseni Kaloshi, zëvendëskryetar i Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur me dt. 7.06.2024;
3. Shqyrtimi i draft-planit të punës së Komisionit për sesionin vjeshtor 2024;
4. Të ndryshme;

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtura më 7.06. 2024.

Procesverbali i mbledhjes së mbajtura me 7.06. 2024, u miratuan pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i draft planit të punës së Komisionit, për sesionin vjeshtor 2024;

Zëvendëskryetari, e informoi komisionin se në bazë të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës, Komisioni përgatitë Planin e punës, për sesionin vjeshtor 2024.

Duke u bazuar në fushëveprimin e komisionit, në Plan të punës përfshihen aktivitetet dhe objektivat e komisionit, siç janë: raportimi i ministrave të linjës, procedurat e mbikëqyrjes së zbatimit të ligjeve, vizitat në terren me autoritetet Komunale, dhe çështjet tjera me prioritet.

Fjalën për diskutim iu dha anëtarëve të komisionit për të ofruar propozimet apo sugjerimet eventual, në mënyrë që i njëjti të miratohet.

Enis Kervan: theksoi se Plani i punës së komisionit për vitin 2024 ka qenë i hartuar mirë, mirëpo për arsye të rrethanave të njohura nuk janë realizuar aktivitetet në periudha të caktuara.

Ai ngriti një çështje tjetër, diskutoi rreth rregullave të organizimit të brendshëm të komisionit. Propozimi i tij ishte që pozita e udhëheqjes në komisionit të zëvendësohet me një anëtar tjetër në vend të zëvendëskryetarit të parë, duke pasur parasysh se pozita e nënkryetarit të dytë i takon përfaqësimit nga radha e komunitetit jo shumicë. Në këtë drejtim, propozoi që Komisionin ta kryeson Bahrim Shabani. Ai kërkoi që kjo çështje të shtjellohet dhe të mirëinterpretim ligjor. Shprehu qëndrimin e tij, nuk do të mbështet hartimin e planit të punës për vitin 2024, nëse nuk miratohet propozimi i tij.

Ngriti edhe një çështje tjetër, sa i përket çështjes së zbatimit të Ligjeve, që tri vite komisioni nuk ka filluar procedurën e monitorimit të Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve dhe Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, me ç' rast asnjëherë nuk është ftuar ministri i linjës përkatëse. Në praktikë, kjo çështje sjell pengesa të shumta nga shpesh hasen shkelje e të drejtës së përdorimit të gjuhëve, si në nivel qendror ashtu edhe në atë lokal.

Arijeta Rexhepi, në kuadër të ushtrimit të punëve të përcaktuara, komisioni zbaton dhe i përmbahet procedurave të përcaktuara me Rregulloren e punës së Kuvendit. Ajo konsideron se komisioni duhet të miratojë Planin e punës së sesionit vjeshtor 2024, me mundësi që e njëjta të rishikohet dhe plotësohet në përputhje me kërkesat dhe nevojat tona. Në bazë të realizimit të planit të punës në plotëni, konsideron se komisioni duhet të jetë më azhur në realizimin e afateve kohore.

Valentina Bunjaku Rexhepi, theksoi se Komisioni funksionon dhe vepron në bazë të Rregullores së Kuvendit. Në bazë të organizimit të brendshëm, mbledhjen e Komisioni e kryeson kryetari, në rast të mungesës së tij mbledhjen e thërret nënkryetari i parë apo i dytë.

Zëvendëskryetari, tha sa i përket temës së ngritur nga parafolësi lidhur me pyetjen e zëvendësimit të vendit të nënkryetarit të parë, kjo çështje nuk është në juridiksionin e komisionit.

Ai konsideron se Komisioni funksionon në bazë të Rregullores së Kuvendit si dhe dispozitat rregullojnë organizimin e brendshëm të komisionit, të cilat rregulla i respektojë me përpikëri.

Pas diskutimeve, zëvendëskryetari konstatoi se Komisioni në bazë të votimit unanim, nxori këtë:

Përfundim

Miratohet Plani i punës së Komisionit, për sesionin vjeshtor 2024, me propozim që i njëjti të ndryshohet dhe plotësohet në bazë të kërkesave të anëtarëve të komisionit.

Mbledhja përfundoi në orën 10:00.

E përgatiti: Stafi mbështetës i Komisionit.

Hydajet Hyseni Kaloshi,

Zëvendëskryetar i Komisionit